

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Kompania Vesa shpk është një biznes i cili operon ne industrinë e hotelerisë dhe në fund të vitit kishte këto pasqyra financiare.

Vesa shpk-Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

	€'000
Fitimi operativ	2,130
Të ardhurat nga interesi	126
Shpenzimet e financimit(interetit)	(387)
Fitimi para tatimit	1,869
Tatimi në te ardhura	<u>(341)</u>
Fitimi neto i vitit	1,528

Vesa shpk -Pasqyra e Pozitës Financiare 31 Dhjetor

	2016	2015
	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Toka dhe makineritë	101,650	95,300
Prona investuese	15,000	19,625
Total pasuritë jo-qarkulluese	116,650	114,925
Stoqet	6,300	2,600
Llog.e Arkëtueshme	11,460	10,850
Paraja e gatshme edhe ekuivalentët	8,600	-
Total pas.qarkulluese	26,360	13,450
Total pasuritë	143,010	128,375

Ekuiteti

Aksionet e zakonshme	48,000	40,000
Premia nga aks. e zakoshme	13,000	5,000
Aksionet preferenciale	2,600	2,600
Fitimet e mbajtura	3,573	2,595
Rezerva e rivlerësimit	21,540	18,300
Total Ekuiteti	88,713	68,495

Detyrimet afatgjata

Kredia bankare	42,311	48,800
Total Detyrimet afatgjata	42,311	48,800

Detyrimet afatshkurta

Llog e pagueshme	9,216	7,450
Overdrafti (mbitërheqja)	-	1,010
Akrualet	610	120
Tatimi i pagueshëm	2,160	2,500
Total detyrimet afatshkurta	11,986	11,080
Total Ekuiteti dhe detyrimet	143,010	128,375

Ndryshimet në ekuitet për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016						
	Aksionet		Aksionet	Fitimet e	Rezerva e	
	E zakonshme	Premia	Preferenciale mbajtura		Rivlerësimi	Total
	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000
Më 1 janar 2012	40,000	5,000	2,600	2,595	18,300	68,495
Emetimi I aksioneve	8,000	8,000				16,000
Dividenda - Preferenciale				(200)		(200)
Dividenda e zakonshme				(350)		(350)
Fitimi neto				1,528		
Rivlerësimi					3,240	
Më 31 Dhjetor 2016	48,000	13,000	2,600	3,573	21,540	88,713

Shënim:

- i. Gjatë vitit Toka dhe Makineritë të cilat kishin kosto në vlerë 540,000 € ishin shitur për 240,000€. Ato pasuri ishin blerë gjatë vitit 2013. Vesa shpk llogaritë zhvlerësimin me normë 10 % me metodën drejtvizore për komplet vitin e blerjes dhe nuk llogaritë në vitin e shitjes fare zhvlerësim .
- ii. Shpenzimi i zhvlerësimit për Tokën dhe Makineritë në vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016 është 1,860,000 €.
- iii. Pronat investuese ishin shitur pa fitim.

Kërkohet :

Përgatiteni Pasqyrën e rrjedhave të arkës së kompanisë Vesa shpk për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016, duke u bazuar ne SNK 7 me metodën indirekte.

Zgjidhja e problemit 1

Pasqyra e rrjedhave të arkës së Vesa shpk për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	!'000	!'000	
Fitimi para tatimit	1,869		
Korrigjimet për			
Të hyrat nga interesi	(126)		
Shpenz e zhvlerësimit	1,860		
Humbja nga shitja e tokës dhe makinerisë	138		
Shpenz. E interesit	<u>387</u>		
	4,128		
Rritja në të Arkëtueshmet	(610)		
Rritja në stoqe	(3,700)		
Rritja në të pagueshmet	1,766		
Rritja në Akruale	490		
Paraja e gjeneruar nga operacionet	2,074		
Interesi I paguar	(387)		
Interesi I pranuar	126		
Tatimi I paguar	(681)		
Paraja e gatshme nga A.operative		1,132	
Paraja nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjen e Tokës dhe makinerisë	(5,348)		
Arkëtimet nga shitja e Tokës dhe makinerisë	240		
Arkëtimet nga shitja e pronës investuese	4,625		
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese		(483)	
Paraja nga aktivitetet financuese			
Arketimet nga emetimi I aksioneve	16,000		
Pagesat për kredinë	(6,489)		
Dividenda e paguar	(550)		
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		8,961	
Rritja në P.e gatshme dhe ekuivalentët (1,132-483+8,961)			9,610
Paraja dhe ekuivalentët në fillim të vitit	Shënimi 1		(1,010)
Paraja dhe ekuivalentët në fund të vitit	Shënimi 1		8,600

Shënimi 1	2012	2011
	'000	'000
Paraja e gatshme	8,600	-
Overdrafti	-	(1,010)
Paraja dhe ekuivalentët	8,600	(1,010)

Shitja e tokës dhe makinerisë	!'000	
Kosto		540
- Zhvlerësimi I akumuluar	-	162
VNL në datën e shitjes		378
Vlera e shitjes		240
Humbja nga shitja		(138)

Tatimi i pagueshëm

Tatimi I paguar	681	Saldo ' 2,500
		Shpenzimet 341
		S" 2,841

Toka dhe makineritë(VNL)

Saldo ' 95,300	Zhvlerësimi 1,860
Rezerva e rivlerësimit 3,240	Pasuritë e shitura 378
<u>Blerjet e pasurive 5,348</u>	
Saldo "101,650	

Problemi 2

a)

Më 30 Shtator 2016 drejtorët e kompanisë Qielli Shpk kanë mbajtur një takim për të diskutuar rreth disa çështjeve të cilat kishin të bënin me finalizimin e pasqyrave financiare për vitin që kishte përfunduar më 30 Qershor 2016:

(i) Më 3 Korrik kishte rënë një zjarr në depot e kompanisë dhe kishte shkatërruar stocë të cilat kishin kushtuar 100,000 € dhe kishin vlerë neto të realizueshme 150,000 €.

(ii) Në korrik 2016 Qielli shpk kishte pranuar informatën se klienti më i madh i tyre kishte falimentuar. Më 30 Qershor ky klient i kishte borxh kompanisë tonë 235,000 €, tani pritët që nga ky klient të arkëtohen vetëm nga 10 cent për çdo 1€ që na kishte borxh ky klient.

(iii) Në Korrik 2016 Qielli shpk ka shitur disa stocë për 75,000 € të cilat stocë kishin qëndruar në depo për dy vite me radhë. Këto stocë ishin paraqitur në pasqyrat financiare më 30 Qershor 2016 me kosto në vlerë prej 105,000 €.

(iv) Më 30 Qershor 2016, një punëtore kishte rrëshqitur gjatë punës dhe kishte dëmtuar shpinën e saj. Kjo punëtore kishte ngritur padi, më 10 Gusht 2016 juristët e kompanisë informuan se ka shumë gjasa që kompania do të gjendet fajtor dhe do të duhet të paguhen 33,000 € punëtore. Punëtorja kishte punuar për kompaninë për 4 vite me radhë.

Kërkesa:

Këshilloni Bordin e drejtorëve se si duhet të i trajtojë në kontabilitet këto çështje sipas SNK 37 "Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente". Përgjigjen tuaj mbështeteni me arsyet për trajtimin e sugjeruar tuajin.

(10 pikë)

b) Kur Ontexi, një biznes individual, viti financiar i të cilit është më 31 dhjetor çdo vit, ekstraktoj një bilanc vërtetues më 31 dhjetor 2016, ai pa se saldo debitore është më e lartë se saldo kreditore për €5,038. Diferenca ishte regjistruar në llogarinë pezull. Diferencat e mëposhtme dolën nga hetimi:

1. Kthimet e blerjeve prej €189 ishin përfshirë në kthimet e shitjeve.
2. Gjatë nënshkrimit të ditarit të çeqeve, pronari kuptoi se ai kishte harruar t'i regjistrojë pagesën e dy çeqeve prej €125 dhe €249 në lidhje me shpenzimet e elektrike dhe shpenzimet e telefonit.
3. Regjistrimi në lidhje me parapagimet e qirasë prej €500 i ishte debituar llogarisë pezull dhe kredituar në llogarinë e qirasë akruale gabimisht.
4. Makina me vlerë prej €4,600 u prezantua në biznesin e tij dhe regjistrimet e vetme të bëra ishin debitimi në llogarinë e pajisjeve si dhe kontabilizimi për zhvlerësimin. Makinat zhvlerësohen me një normë prej 12.5% të saldos zbritëse, ndërsa pajisjet zhvlerësohen me një normë prej 10% në vit me metodën lineare. Politika e zhvlerësimit të Ontexi, është zhvlerësimi i plotë në vitin e blerjes.
5. Fatura për dritat dhe nxemjen prej €240 ishte gjetur. Nuk ishte procesuar në konton e shpenzimet mirëpo ishte paraqitur saktë në librin e arkës. Fatura e Ontexi për dritat dhe nxemjen për secilin muaj paguhet automatikisht nga një urdhërpagesë prej llogarisë bankare, në ditën e fundit të secilit muaj.
6. Ontexi kontabilizoi dhe shiti mallra me afat pagese me vlerë prej €1,240 me bazë shitjeje ose kthimi, ku data e fundit e lejuar për kthim për këto mallra ishte 01 shkurt 2017. Sipas SNK 18 këto mallra nuk duhet njohur në të hyrat për vitin 2016, ndërsa ai i kishte regjistruar edhe të hyrat nga shitja edhe koston e mallit të shitur në këto mallra. Këto mallra i kishin kushtuar Ontexit €900.
7. Një rënie në lejimin e borxheve të dyshimta prej €800 ishte debituar në llogarinë e borxheve të këqija dhe kredituar në llogarinë pezull.

Kërkohet:

Përgatitni hyrjet në ditar për Ontexi për regjistrimet dhe/ose përmirësimet, siç është e përshtatshme, transaksionet relevante nga informatat e mësipërme për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016.

(10 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 2

a)

(i) Pasi që zjarri ka rënë në depo dhe I ka shkatërruar stoqet pas fundit të vitit kjo konsiderohet si ngjarje që nuk kërkon korrigjim. Nëse vlera e stoqeve të dëmtuara është material duhet të bëhet shpalosje në pasyra, në të kundërtën nuk ka nevojë as për shpalosje.

(ii) Kjo është një ngjarje e cila kërkon korrigjim pasi që ka të bëjë me të dhëna që është dashur të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare në fund të vitit. Kjo ngjarje duhet të korrigohet si më poshtë

Debi	SHpenzimet e borxheve të këqija (235,000*0.9)	211,500
Kredi	LLogaritë e Arkëtueshme	211,500

(iii) Edhe kjo është ngjarje që kërkon korrigjim pasi që stoqet është dashur të maten me vlerën neto të realizueshme në datën 30 Qershor .

(iv) Poashtu edhe kjo ngjarje kërkon korrigjim të pasqyrave financiare pasi që ngjarja ka ndodhur ende pa u mbyllur vitit ,dhe me gjasë ata do të kompenzojnë punëtoresh me 33,000 €.

Kjo kompani duhet të njoh një provision në pasyrat e veta financiare duke regjistruar:

Debi	SHpenzimet e provizionimit	33,000
Kredi	Provizionet	33,000

(b)

Për t'u korrigjuar	
Debi. Llogaria pezull	378
Kredi. Kthimet e shitjeve	189
Kredi Kthimet e Blerjeve	189

Për t'u korrigjuar	
Debi Shpenzimet elektrike	125
Debi. Shpenzimet e telefonit	249
Kredi Paraja e gatshme	374

Për t'u korrigjuar	
Debi Parapagimi i qirasë	500
Debi Qiraja Akruale	500
Kredi Llogaria pezull	500
Kredi Shpenzimet e qirasë	500

Për t'u korrigjuar	
Debi. Makina - PFP	4,600
Debi Llogaria pezull	4,600
Kredi Paraja e gatshme	4,600
Kredi Pajisjet	4,600
Debi. Shpenzimet e zhvlerësimit	115
Debi Zhvlerësimi i akumuluar - Pajisjet	460
Kredi Zhvlerësimi i akumuluar -Makina	575

Për t'u korrigjuar	
Debi. Shpenzimet e dritave & nxemjes	240
Kredi Llogaria pezull	240

Për t'u korrigjuar	
Debi. Shitjet	1,240
Kredi Të arkëtueshmet tregtare	1,240
Debi. Stoqet në fund	900
Kredi Kosto e shitjes	900

Për t'u korrigjuar	
Debi. Llogaria pezull	800
Kredi. Shpenzimet e borxheve të këqija	800
Debi. Lejimet për b. e d.	800
Kredi. Te hyrat nga b.d	800

Problemi 3

Draft pasqyrat e pozitës financiare të Sting dhe filialit të saj Persi më 31 tetor 2015 janë si vijon :

	<i>Sting</i>		<i>Persi</i>	
	€'000	€'000	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>				
Pasuritë jo-qarkulluese				
Pasuritë e prekshme				
Toka dhe Ndërtesat		315,000		278,000
Fabrika		<u>285,000</u>		<u>220,000</u>
		600,000		498,000
Investimet				
Aksionet në Persi me kosto		660,000		-
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Stoqet	357,000		252,000	
Llogaritë e arkëtueshme	525,000		126,000	
Paraja në bankë	<u>158,000</u>		<u>30,000</u>	
		<u>1,040,000</u>		<u>408,000</u>
		<u>2,300,000</u>		<u>906,000</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>				
Ekuiteti				
Aksione të zakonshme nga €1 secila		1,500,000		600,000
Fitimet e mbajtura		<u>580,000</u>		<u>212,000</u>
		2,080,000		812,000
Detyrimet afatshkurtëra				
Llogaritë e pagueshme		<u>220,000</u>		<u>94,000</u>
<i>Total ekuiteti dhe detyrimet</i>		<u>2,300,000</u>		<u>906,000</u>

Informacioni i mëposhtëm është gjithashtu në dispozicion.

- (a) Sting ka blerë 480 milionë aksione të Persi disa vite më parë, kur Persi kishte fitime te mbajtura prej €95 milionë në rezerva. Vlera e drejtë e interesit të pa kontrollueshëm në datën e blerjes ishte €165 milionë.
- (b) Në datën e blerjes, toka e Persi ishte rivlerësuar në €70 milionë më shumë se vlera në libra. Rivlerësimi nuk u regjistrua në llogaritë e Persi.
- (c) Stoqet e Persi përfshijnë mallrat e blera nga Sting me çmim i cili përfshinë fitimin për Sting prej €12 milionë.
- (d) Më 31 tetor 2015 Persi i ka borxh €25 milionë Sting për mallrat e blera gjatë vitit.

Kërkohet

- (a) Llogaritni në total zërin e mirë të shfaqur në konsolidim.
- (b) Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare të konsoliduar të Sting me 31 tetor 2015.

(20 pikë)

Zgjidhja(3)

(a) Kalkulimi i zërit të mirë

	€'000	€'000
Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		660,000
Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje		165,000
Minus vlera e drejtë neto në datën e blerjes e pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve të pranuar:		
Kapitali aksionar	600,000	
Fitimet e mbajtura në blerje	95,000	
Korrigjimet e vlerës së drejtë të tokës	70,000	
		<u>(765,000)</u>
Zëri i mirë		60,000

(b) STING GROUP
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE E KONSOLIDUAR ME 31 TETOR 20X5

	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Zëri i mirë		60,000
Toka dhe ndërtesat (315 + 278 + 70)		663,000
Fabrika (285 + 220)		<u>505,000</u>
		1,228,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet (357 + 252 - 12)	597,000	
Ll.Arkëtueshme (525 + 126 - 25)	626,000	
Paraja në bankë (158 + 30)	<u>188,000</u>	
		<u>1,411,000</u>
		<u>2,639,000</u>

Ekuiteti dhe detyrimet

Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë

Aksione të zakonshme nga €1 secila	1,500,000
Rezervat (W2)	661,600
Interesi i pa kontrollueshëm (W3)	<u>188,400</u>
	2,350,000
Detyrimet afatshkurtra	
Ll.Pagueshme (220 + 94 - 25)	<u>289,000</u>
<i>Total ekuiteti dhe detyrimet</i>	<u><u>2,639,000</u></u>

Llogaritjet

1 *Struktura e grupit*

$$\frac{480\text{m}}{600\text{m}} = 80\%$$

2 *Fitimet e mbajtura*

	<i>Spyder</i>	<i>Phly</i>
	€m	€m
Sipas pyetjes	580.0	212
Fitimi i pa-realizuar	(12.0)	
Fitimet e mbajtura para blerjes		<u>(95)</u>
		<u>117</u>
Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes		
Phly (80% × 117)	<u>93.6</u>	
Fitimet e mbajtura të grupit	<u>661.6</u>	

3 *Interesi i pa kontrollueshëm*

	€m
Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes	165.0
Plus pjesa e IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (20% × 117)	<u>23.4</u>
IJK në datën e raportimit	<u>188.4</u>

Problemi 4

a) Saldo në fund e stoqeve të Epsilon arriti në € 284,000 në datën e raportimit më 30 Shtator 2016. Ky total përfshin dy linja të stoqeve për të cilat kompania është e pasigurtë.

- 1 500 artikuj që kishin kushtuar €15 secila dhe të cilat ishin përfshirë në €7,500. Këto mallëra u gjetën të dëmtuara në fund të periudhës raportuese. Kostot për t'i sjell mallrat në gjendje për shitje pas periudhës së raportimit kushtonin €1,800 dhe ato pastaj u shitën për €20 secila. Shpenzimet e shitjes ishin €400.
- 2 100 artikuj që kishin kushtuar €10 secila. Pas periudhës së raportimit ato u shitën për €8 secila, me shpenzimet e shitjes prej €150.

Kërkohet: Cila shifër duhet të paraqitet në shpalosjen e pasqyrës së pozitës financiare të Epsilon për stoqet ?

(5 pikë)

Artikulli 1

Kosto:

$$500 \text{ nj} \times 15\text{€} = 7,500\text{€}$$

VNR:

$$\text{Cmimi i pritur i shitjes: } 500\text{nj} \times 20 \text{ eur} = 10,000 \text{ eur}$$

$$\text{Kostot per t'i sjell mallrat në gjendje për shitje: } (1,800 \text{ eur})$$

$$\text{Shpenzimet e shitjes} \quad \quad \quad \underline{(400 \text{ eur})}$$

$$\text{Vlera neto e realizueshme} \quad \quad \quad \underline{7,800 \text{ eur}}$$

Me qenë se VNR është më e lartë se shuma e kostos, për artikullin 1 nuk ka nevojë të bëhet korigjimi i vlerës së stoqeve në libra

Artikulli 2

Kosto:

$$100 \text{ nj} \times 10\text{€} = 1,000\text{€}$$

VNR:

$$\text{Cmimi i pritur i shitjes: } 100\text{nj} \times 8 \text{ eur} = 800 \text{ eur}$$

$$\text{Shpenzimet e shitjes} \quad \quad \quad \underline{(150 \text{ eur})}$$

$$\text{Vlera neto e realizueshme} \quad \quad \quad \underline{650 \text{ eur}}$$

Me qenë se VNR është më e ulët se shuma e kostos për 350 eur, për artikullin 2 sipas SNK 2 Stoqet duhet të bëhet korrigjimi i vlerës së stoqeve në libra. Andaj, vlera e stoqeve në fund pas korrigjimit do të jetë si në vijim:

284,000

Artikulli 1 - Nuk ka asnjë ndryshim pasi që VNR tejkalon koston

Artikulli 2 (350) Zvogëlim i stoqeve (1,000 - 650)

Stoqet e korrigjuara 283,650

b) Bilanci provues i Fredit nuk u balancua kështu që ai hapi një llogari pezul me saldo debitore prej €346. Llogaritë kontrolluese mbahen për llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme.

Fredi zbuloi se :

- 1 Libri i shitjeve ditore u nënvlerësua me €400.
- 2 Blerjet prej €520 nga libri i blerjeve ditore u regjistruan vetëm në llogarinë kontrolluese të të pagueshmeve.
- 3 Fitimi nga shitja e pasurive jo-qarkulluese prej €670 u regjistrua në llogarinë e të ardhurave të tjera si €760.

Kërkohet :Cila është saldo e mbetur në llogarinë pezull të Fredit, pasi të korrigjohen këto gabime?

(5 pikë)

LLOGARIA PEZULL

	€		€
Saldo ne fillim	346	Blerjet (2)	520
Saldo balancuese	<u>264</u>	Të ardhurat e tjera (3)	<u>90</u>
	<u>610</u>		<u>610</u>
		Saldo ne fund	<u>264</u>

c) Më 31 dhjetor 2014 struktura e kapitalit të një kompanie ishte si më poshtë:

	€
Kapitali aksionar i zakonshëm (500,000 aksione nga 25c secila)	125,000
Premia në aksione	100,000

Në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 kompania ka bërë një emetim të të drejtave me 1 aksion për çdo 2 aksione të mbajtura me € 1 për aksion dhe kjo është marrë plotësisht. Më vonë gjatë vitit, kompania solli një emetim bonus prej 1 aksioneve për çdo 5 të mbajtura, duke përdorur llogarinë e premisë në aksione për këtë qëllim.

Kërkohet: Cila ishte struktura e kapitalit të kompanisë më 31 dhjetor 2015? **(5 pikë)**

Kapitali aksionar = 125,000 + 62,500 të drejta për 250,000 aksione me nga 25c (500,000/2) + 37,500 bonus për 150,000 aksione me nga 25c (750,000/5) = 225,000

Premia në aksione = 100,000 + 187,500 të drejta (250,000 × 75c) - 37,500 bonus (150,000 × 25c) = 250,000

d) Harmonizimi bankar në vijim është përgatitur nga një kontabilist praktikant:

	€
Mbitërheqja sipas bankës:	3,860
Minus: Çeçet e pa-paraqitura	<u>9,160</u>
	5,300
Plus: Depozitat në tranzit	<u>16,690</u>
Paraja e gatshme në bankë	<u>21,990</u>

Kërkohet: Cila duhet të jetë balanca e saktë në librin e parasë së gatshme ?

(5 pikë)

Mbitërheqja sipas bankës	(3,860)
Minus: Çeçet e pa-paraqitura	(9,160)
Plus: Depozitat në tranzit	<u>16,690</u>
Paraja e gatshme në bankë	<u>3,670</u>

(Totali 20 pikë)

Problemi 5

Froni, një tregtar individual, ekstraktojë Bilancin Vërtetues të mëposhtëm më 31 dhjetor 2016.

BILANCI VËRTETUES MË 31 DHJETOR 2016

Përshkrimi i llogarive	Debi	Kredi
	€	€
Kapitali më 01 janar 2016		26,100
Llogaritë e arkëtueshme	41,000	
Parja e gatshme	2,802	
Llogaritë e pagueshme		34,500
Orenditë dhe Pajisjet me kosto	42,200	
Zbritjet e marra		1,200
Stoqet më 01 janar 2016	18,460	
Shitjet		487,550
Blerjet	379,590	
Makinat me kosto	45,730	
Ndriçimi dhe ngrohja	6,100	
Shpenzimet motorike	3,250	
Qiraja	10,750	
Shpenzimet e përgjithshme	9,475	
Overdrafti bankar		20,100
Zhvlerësimi i akumuluar: Orendi dhe pajisje		2,200
Zhvlerësimi i akumuluar: Makina		15,292
Tërheqjet	27,585	
	586,942	586,942

Informatat e mëposhtme janë gjithashtu në dispozicion më 31 dhjetor 2016:

- (a) Akrualet për shpenzimet motorike janë 520€
- (b) Parapagimet për qiranë janë 450€, të cilat janë përfshirë si shpenzime në Bilancin Vërtetues
- (c) Duhet të ngarkohet zhvlerësimi si në vijim për pasuritë jo-qarkulluese:
 - Makinat: 20% e kostos
 - Orenditë dhe Pajisjet: 10% me metodën e saldosh zbritëse
- (d) Stokset në fund të vitit u vlerësuan për 20,250€
- (e) Froni i mori disa stoke në vlerë prej 800€ për përdorim personal. Çmimi i shitës i këtyre stoqeve është 1,600€.

Kërkohet:

1. Cili është efekti neto mbi fitimin e vitit pas rregullimit të këtyre çështjeve të sipërpërmendura nga (a) deri në (c). **(5 pikë)**

2. Përgatitni Pasqyrën e të Ardhurave dhe atë të Pozitës Financiare të Froni më 31 dhjetor 2016. **(15 pikë)**

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

(1) Efektet janë si në vijim:

(a) Akruali për shpenzimet motorike - 520€ shpenzime shtesë, prandaj zvogëlim në fitim.

(b) Parapagimi i qirasë - 450€ zvogëlim në shpenzime, prandaj rritje në fitim.

(c) Zhvlerësimi në total për të dy llojet e PJQ -13,146€ shpenzime shtesë, prandaj zvogëlim në fitim.

Total efekti në fitimin neto = - 520 + 450 - 13,146 = 13,216 zvogëlim

Kalkulimet: Shpenzimet e zhvlerësimit

Makinat: $45,730€ \times 20\% = 9,146€$

Orenditë dhe Pajisjet: $10\% \times (42,200€ - 2,200€) = 4,000€$

Total: $4,000€ + 9,146€ = 13,146€$

(2)

Froni

Pasqyra e të Ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016

	€
Të hyrat nga shitja	487,550
KMSH	
Stoqet në fillim	18,460
+ Blerjet	(379,590 - 800)
- Stoqet në fund	20,250
	<u>(377,000)</u>
Fitimi Bruto	110,550
Zbritjet e marra	<u>1,200</u>
	111,750
Shpenzimet:	
Motorike (3,250 + 520)	(3,770)
Ndriçimi dhe ngrohja	(6,100)
Të përgjithshme	(9,475)
Qiraja (L1.1)	(10,300)
Zhvlerësimi (L1.2)	<u>(13,146)</u>
Fitimi Neto	68,959

Llogaritja 1. Shpenzimet e qirasë

Të regjistruara gjatë vitit

Debi Shpenzimet e qirasë 10,750€

Kredi Paraja e gatshme 10,750€

Korrigjimi në fund të vitit

Debi Parapagimi 450€

Kredi Shpenzimet e qirasë 450€

Llogaritja 2. Shpenzimet e zhvlerësimit

Makinat (me metodën drejtvizore): $45,730€ \times 20\% = 9,146€$

Orenditë dhe Pajisjet (me metodën e saldosh zbritëse): $(42,200€ - 2,200€) \times 10\% = 4,000€$

13,146€

Froni

Pasqyra e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2016

	€	€	€
PASURITË			
Pasuritë jo-qarkulluese	<u>Kosto</u>	<u>Zhvlerësimi i akumuluar</u>	<u>VNL</u>
Makinat	45,730	(24,438)	21,292
Orenditë dhe Pajisjet	42,200	(6,200)	36,000
Total pasuritë jo-qarkulluese			57,292
Pasuritë qarkulluese			
Stoqet			20,250
Llogaritë e arkëtueshme			41,000
Parapagimet			450
Paraja e gatshme			2,802
Total pasuritë qarkulluese			44,502
TOTAL PASURITË			121,794
EKUITETI			
Kapitali në fillim			26,100
Fitimi Neto			68,959
Tërheqjet (27,585 + 800)			28,385
Total ekuiteti			66,674
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme			34,500
Akrualet			520
Overdrafti bankar			20,100
Total Detyrimet			55,120
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET			121,794